

**OBJEKTI: “NDËRTIM I TREGUT BUJQËSOR NË LAGJEN MINATORI,
BASHKIA BULQIZË”**

RAPORTI TEKNIK

Objekti: “NDËRTIM I TREGUT
BUJQËSOR NË LAGJEN MINATORI,
BASHKIA BULQIZË”.

PROJEKT - ZBATIMI

VITI 2022

**OBJEKTI: “NDËRTIM I TREGUT BUJQËSOR NË LAGJEN MINATORI,
BASHKIA BULQIZË”**

PËRMBAJTJA E RAPORTIT TEKNIK

A. Hyrje:

Objekti qe po trajtohet ne kete projekt ndodhet ne Bashkine Bulqize te Qarkut te Dibres, me nje popullsi prej 32,210 banoresh sipas censusit te 2011, qe i perket zones se Shqiperise Verilindore.

Ne kete zone mbizoteron pergjithesisht nje terren kodrionoro - malor.

Klima eshte e bute dhe me shume lageshti ne periudhen dimerore, qe shoqerohet me temperatura deri ne -10°C , ndersa temperatura mesatare vjetore eshte $10\pm 20^{\circ}\text{C}$.

Me porosi te Bashkise Bulqize, eshte realizuar Projekti i Zbatimit per “Ndertimin e Tregut Bujqesor ne Lagjen Minatori”, investim i cili eshte shume i nevojshem per zonen pasi ne kete menyre realizohet edhe perqendrimi ne nje ambient te caktuar i aktiviteteve agro – kulturore ne lidhje me tregtimin e fruta perimeve dhe cfaredolloj produkti tjetër bujqesor, sipas kulturave te ndryshme qe kultivojne banoret e zones.

B. Gjendja Aktuale e Objektivit:

Zona qe eshte vene ne dispozicion nga Bashkia Bulqize per Ndertimin e ketij Tregu, aktualisht eshte nje shesh i lire i pasistemuar ne pronesi te vete Bashkise, si dhe me disa hyrje te posaçme e akses ne nje nga rruget kryesore te qytetit.

Ky shesh eshte percaktuar nga vete Bashkia Bulqize, e cila do ta perdore per ndertimin e tregut i cili do ti sherbeje shume banoreve te zones per tregtimin e fruta perimeve sezonale. Propozimi i vete Investitorit eshte realizimi ne kohe rekord i ketij investimi strategjik, te cilat do te trajtohen me gjeresisht gjate realizimit te projektit.


Me poshte po paraqesim disa foto ne lidhje me hapesiren ku do te realizohet dhe investimi perkates.

C. Foto nga Gjendja Aktuale:

**OBJEKTI: “NDËRTIM I TREGUT BUJQËSOR NË LAGJEN MINATORI,
BASHKIA BULQIZË”**



**OBJEKTI: “NDËRTIM I TREGUT BUJQËSOR NË LAGJEN MINATORI,
BASHKIA BULQIZË”**



**OBJEKTI: “NDËRTIM I TREGUT BUJQËSOR NË LAGJEN MINATORI,
BASHKIA BULQIZË”**

D. ZGJIDHJA E PROJEKTIT

1. Punime Germimi dhe Mbushje:

Punimet e ndertimit te tregut do te nisin fillimisht nga germimet e nevojshme qe duhet te behen ne sheshin perkates. Fillimisht do te germohet per lirimin e sheshit dhe arrijten e nje kuote te caktuar ne te gjithe siperfaqen, e cila me pas do te mbushet me zhavorr para fillimit te ndertimit. Permendim ketu edhe prishje te strukturave te ndryshme prej betoni apo guri te panevojshme, per lirimin total te hapësirave te sheshit, si dhe transportimin e materialeve inerte qe do te krijohen nga germimet.

2. Punime Konstruksioni Beton/Arme:

Sikunder kemi te bejme me nje ndertim te ri me siperfaqe te konsiderueshme te gjurmes rreth 300 m², eshte e nevojshme qe struktura te kete plinta te thellesise se duhur ne menyre qe konstruksioni te jete i qendrueshem, ku ne rastin tone do te aplikohen rreth 18 plinta te permasave 180x180 cm dhe thellesi qe shkon deri ne 2 m. Plintat do te realizohen me armimin e duhur sipas skemes se Projektit.

Pas realizimit te plintave (themeleve) dhe lidhja e tyre ne koke nepermjet nje arkitrau perimetral me permasa 30x40 cm, do te vijohet me ndertimin e kolonave prej betoni te armuar me permasa 30x45cm dhe 50x50cm, te cilat do te vazhdojne deri ne lartesine e soletes me kuote +6.3 m.

Ndersa ne lartesine +3.2m do te krijohet edhe nje hapësire e shfrytezueshme brenda ne godine me permasa te brendshme 1175x445 cm, e cila do te sherbeje per zyra, WC etj.

Themelet:

E gjithe godina mbështetet mbi themele me plinta dhe me mure lidhes midis kolonave. Plintat do te jene me dimensione 180 x 180 cm dhe do te zhyten ne thellesine $h = 200$ cm. Sforcimet e lejuara në tabanin e themelit janë marrë 1.8 kg/cm² ne mungese te raportit gjeologo-inxhinierik. Nisur nga kjo kemi bërë zgjedhjen e tipit te themelit që është parashikuar një nënshtresë zhavorri me trashesi 15 cm dhe nje nënshtresë betoni për pastërti M-150 me trashesi 10 cm.

Themelet janë llogaritur me beton marka M-200 (C – 16/20), me koeficient sigurie $\gamma_c=1.5$ dhe armaturë Çelik S-500.

Kolonat:

Kolonat janë të shpërndara sipas akseve dhe kanë hap të ndryshëm. Ato janë në përmasa 30x45cm dhe 50x50cm. Kolonat dhe muret janë llogaritur me beton marka M-200

OBJEKTI: “NDËRTIM I TREGUT BUJQËSOR NË LAGJEN MINATORI, BASHKIA BULQIZË”

(C – 16/20), me koeficient sigurie $\gamma_c=1.5$) dhe armaturë Çelik S-500. (Kufiri i rrjedhshmërisë 5000 kg/cm², koeficient sigurie $\gamma_s=1.15$ dhe zgjatim relative $\gamma_{12-18\%}$).

Traret:

Sistemi i trarëve në këtë strukturë është me përmasa 30 x 40 cm, të cilet mbështëten mbi rrjeten e kollonave.

Trarët janë llogaritur me beton marka M-200 (C – 16/20), me koeficient sigurie $\gamma_c=1.5$) dhe armaturë Çelik S-500. (Kufiri i rrjedhshmërisë 5000 kg/cm², koeficient sigurie $\gamma_s=1.15$ dhe zgjatim relative $\gamma_{12-18\%}$)

Soleta:

Soleta do të jete me traveta monolite, të kombinuara me tulla solete me trashësi 25 cm, kurse shkallet me solete monolite me trashësi $h=17$ cm e cila do të punoje në dy drejtime ($L_{max}<6,0m$). Soletat me traveta punojnë në dy drejtime dhe janë llogaritur për çdo travete duke marrë parasysh veprimin e të gjitha ngarkesave që veprojnë në sipërfaqen e soletes që shkarkon mbi një travete. Llogaritja e soletes me traveta është bërë duke marrë si një tra të vazhduar me seksion në formë T me $b=10cm$ dhe $b'=25cm$ duke përdorur programin Sap 2000.

Llogaritja e soletave monolite është bërë në të dy drejtimet.

Soletat janë llogaritur me beton marka M-200 (C – 16/20), me koeficient sigurie $\gamma_c=1.5$) dhe armaturë Çelik S-500. (Kufiri i rrjedhshmërisë 5000 kg/cm², koeficient sigurie $\gamma_s=1.15$ dhe zgjatim relative $\gamma_{12-18\%}$).

Normativat e referimit:

Llogaritja e strukture është bërë sipas kushteve shqiptare të projektimit dhe Eurokodit 2 e në vecanti:

- Kushteve teknike të projektimit KTP-1978; Miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 38, dt.3.5.1978
- Eurokod 2 - 1991: Design of concrete structures; General rules and rules for buildings. (Llogaritja e strukturave prej betoni të armuar, rregulla të përgjithshme dhe rregulla për ndërtesat)
- Eurocode 8: Design of structures for earthquake resistance – DRAFT No. 6, Version for translation, Stage 49, Part 1: “General rules, seismic action and rules for buildings.

Karakteristikat e materialeve:

Traret Beton C – 16/20 me $f_{ck}= 20$ MPa

Kollonat Beton C – 16/20 me $f_{ck}= 20$ MPa

Themelet Beton C – 16/20 me $f_{ck}= 20$ MPa

Soletat Beton C – 16/20 me $f_{ck}= 20$ Mpa

OBJEKTI: “NDËRTIM I TREGUT BUJQËSOR NË LAGJEN MINATORI, BASHKIA BULQIZË”

Shkallet Beton C – 16/20 me $f_{ck} = 20$ MPa

Celiku S-500

Koeficienti i sigurise per hekurin $\gamma_s = 1.15$

Koeficienti i sigurise per betonin $\gamma_c = 1.5$

Metoda e llogaritjes:

Llogaritja perfshin:

- Analizen statike per veprim te ngarkesave te perhershme e te perkohshme.
- Analizen sizmike per veprim te termetit ne planin XY
- Llogaritjen e armatures se kollonave.
- Llogaritjen e armatures se trareve.
- Llogaritja e masave te perqendruara.

Per llogaritjen sizmike do perdoret metoda e masave te perqendruara duke i perqendruar masat ne cdo nyje te rames.

Masat vetjake te trareve dhe te kollonave meren nga karakteristikat e materialeve ne programin e llogaritjes.

Veprimi sizmik:

Ndertimi ndodhet ne zonen 8 balle dhe ne kategori te 2 te truallit.

Atehere sipas kushteve shqiptare te projektimit koeficienti sizmik $KE = 0.25$ dhe koeficienti dinamik $0.65 < B = 0.8 / T_i < 2.0$

Keshtu spektri do te jete si me poshte:

Per T: 0,1 ; 0,2 ; 0,3 ; 0,4 ; 0,5 ; 0,6 ; 0,7 ; 0,8 ; 0,9 ; 1,0 ; 1,1

Nxitimi: 1,08 ; 1,08 ; 1,08 ; 1,08 ; 0,86 ; 0,72 ; 0,62 ; 0,54 ; 0,48 ; 0,43 ; 0,39

Meqenese struktura ka masa te konsiderueshme veprimi sizmik mbi te do te jete dominues ne krahasim me veprimin e eres. Per kete arsye llogaritjet jane bere vetem per veprimin sizmik.

Struktura eshte llogaritur per kombinimet e meposhtme:

1. $1 \cdot q$ vetem ngarkesa e plote.

2. 100% termet + $0,85 \cdot q$

Ku termeti vepron ne plan duke marre veprim 100% ne njerin drejtim dhe 30% ne drejtimin tjeter (ne menyre te alternuar). Meqenese nuk ka shkelje te medha konsol, veprimi vertikal i termetit eshte neglizhuar.

Llogaritja e ngarkesave te soletes:

Percaktimi i ngarkesave dhe i skemes llogaritese:

Do te behen llogaritjet me program nga:

- Ngarkesat e perhershme (pllakat, pesha vetjake, traveta, tulla, suvaja).
- Ngarkesat e perkohshme (pesha e debores).
- Ngarkesa totale (e perkohshme + e perhershme).

OBJEKTI: “NDËRTIM I TREGUT BUJQËSOR NË LAGJEN MINATORI, BASHKIA BULQIZË”

Ngarkesa e plote e peshes vetjake te trareve, kollonave, soletave dhe themeleve merret automatikisht nga programi llogarites ne varesi te peshes volumore dhe karakteristikave te materialit.

Llogaritja e ngarkesave mbi trare:

Ngarkesa nga muret (12 cm) = $0,15 \cdot 2,76 \cdot 1200 \cdot 1,4 = 695 \text{ daN/m}$

Ngarkesa nga muret (25 cm) = $0,25 \cdot 2,9 \cdot 1200 \cdot 1,4 = 1218 \text{ daN/m}$

I gjithe projekti eshte i shoqeruar me shenime dhe me hollesi teknike, te cilat e bejne te qarte dhe te thjeshte, leximin e tij nga inxhinieret e zbatimit.

3. Fasada dhe suvatimet e brendshme:

Fasada eshte realizuar me elemente dekorative (sipas projektit te zbatimit). Ngjyrat e fasadës jane te harmonizuara, në mënyre që objekti të permiresohet vizualisht.

Zgjidhja me e pershtatshme per fasaden do te ishte sistemi kapot, ku fillimisht do te behet veshja me polisterol per rritjen e eficenses energjitike te objektit, me pas suvatimi total i saj me grafiato dhe ngjyra te harmonizuara.

Gjithashtu, pas instalimeve hidraulike dhe elektrike, do te behet edhe suvatimi total ne cdo faqe muri te brendshme te objektit. Muret dhe do të suvatohen me llaç fino deri në 3 cm dhe do të lyhen një dorë astar dhe 2 duar bojë hidromat për tavantet dhe pjesën e sipërme të mureve ndërsa pjesa e poshtme e mureve do të lyhet me 2 duar bojë akrilik me ngjyrë të ndryshme nga boja e pjesës sipër. Gjithashtu në lartësinë e karriges do të vendoset dhe një shirit druri për të mbrojtur muret.

Si fillim bëhet sprucim i mureve dhe tavaneve me llaç çimentoje të lëngët, për përmirësimin e ngjitjës së suvasë dhe rforcimin e sipërfaqeve të muraturës, duke përfshirë skelat e shërbimit dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht sprucimin. Suvatim i realizuar nga një shtresë me trashësi 3 cm llaçi bastard m -25 me përmbajtje për m²: rërë e larë 0,005 m³; llaç gëlqereje m- 1: 2, 0.03 m³; çimento 400, 6.6 kg; ujë, i aplikuar me paravendosje të drejtuesve në mure (shirit me llaç me trashësi 15 cm çdo 1 deri në 1,5 m), dhe e lëmuar me mistri e bërda, duke përfshirë skelat e shërbimit si dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht suvatimin.

4. Lyerje me bojë plastike:

Të gjitha bojrat që do të përdoren duhet të zgjidhen nga një prodhues që ka eksperiencë në këtë fushë. Nuk lejohet përzjerja e dy llojeve të ndryshme markash boje gjatë procesit të punës. Hollimi i bojës duhet të bëhet vetëm sipas udhëzimeve të prodhuesit. Përpara fillimit të lyerjes duhet që të gjitha pajisjet, mobiljet ose objekte të tjera që ndodhen në objekt të mbulohen në mënyrë që të mos bëhen me bojë. Është e domosdoshme, që

OBJEKTI: “NDËRTIM I TREGUT BUJQËSOR NË LAGJEN MINATORI, BASHKIA BULQIZË”

pajisjet ose mobiljet që janë të mbështetura ose të varura në mur të largohen në mënyrë që të bëhet një lyerjë komplet e objektit. Materiali i pastrimit të njollave duhet të jetë me përmbajtje të ulët toksikimi. Pastrimi dhe lyerja duhet të kordinohen në atë mënyrë që gjatë pastrimit të mos ngrihet pluhur ose papastërti dhe të bjerë mbi sipërfaqen e sapolyer. Furçat, kovat dhe enët e tjera ku mbahet boja duhet të jenë të pastra.

Ato duhet të pastrohen shumë mirë përpara çdo përdorimi sidomos kur duhet të punohet me një ngjyrë tjetër. Gjithashtu, duhet të pastrohen kur mbaron lyerja në çdo ditë.

Personeli që do të kryejë lyerjen, duhet të jetë me eksperiencë në këtë fushë dhe duhet të zbatojë të gjitha kushtet teknike të lyerjes sipas KTZ dhe STASH.

Norma është 1 litër bojë hidromat i holluar duhet të përdoret për 2.7 – 3 m² sipërfaqe.

Kjo normë varet nga ashpërsia e sipërfaqes dhe lloji i bojës që përdoret. Në ndërtime të reja para lyerjes duhet të bëhet pastrimi i sipërfaqes që do të lyhet nga pluhurat dhe të shikohen dëmtimet e vogla të saj, të bëhet mbushja e gropave të vogla apo dëmtimeve të sipërfaqes së murit me anë të stukimit me material sintetik dhe bërja gati për lyerje. Para lyerjes duhet të bëhet mbrojtja e sipërfaqeve që nuk do të lyhen (dyer, dritare, etj) me anë të vendosjes së letrave mbrojtëse. Në fillim të procesit të lyerjes bëhet paralyerja e sipërfaqeve të pastruara mire me gëlqere të holluar (Astari).

Në fillim bëhet përgatitja e astarit duke përzier 1 kg gëlqere me 1 litër ujë. Me përzierjen e përgatitur bëhet paralyerja e sipërfaqes vetëm me një dorë. Më pas vazhdohet me lyerjen me bojë si më poshtë: - Bëhet përgatitja e përzierjes së bojës hidromat të lëngshëm me ujë. Lëngu i bojës hollohet me ujë në masën 20 – 30 %. Kësaj përzierje i hidhet pigment derisa të merret ngjyra e dëshiruar.

Bëhet lyerja e sipërfaqes. Lyerja bëhet me dy duar. Norma e përdorimit është 1 litër bojë hidromat i holluar në 2.7 – 3 m. Norma e përdorimit është 1 litër gëlqere e holluar duhet të përdoret për 2 m² lyerje.

5. Punime te Çatise:

Pas realizimit të kolonave dhe trareve fillon montimi i kapriates metalike të çatise.

Kapriata metalike do të realizohet me profile metalike të permasave 40 x 80 mm (shiko projektin), dhe bashkimi i tyre gjithashtu do të realizohet me saldim ose me vida.

Kulmi i kapriates në lidhjen me fundoret e saj do të ketë një disnivel prej rreth 30 cm, në mënyrë që kur të vendoset paneli sanduich të realizohet edhe pjerresia e nevojshme për kullimin e ujerave.

Panelet sanduich janë menduar të jenë të një trashësie të pakten 3 cm, të cilat gjatë montimit të tyre do të kapen me vida të posaçme mbi profilet e kapriates.

Bashkimi i paneleve përgjatë gjithë kulmit me të lartë që i bie në mesin e Strukturave do të bëhet me llamarine të hollë e një gjëresie rreth 30 cm, në mënyrë që të shmangët edhe dëmtimi i tyre nga faktore të ndryshëm atmosferike.

OBJEKTI: “NDËRTIM I TREGUT BUJQËSOR NË LAGJEN MINATORI, BASHKIA BULQIZË”

Krahas elementeve të lartpërmendur, e nevojshme për kompletimin e çatise është edhe sistemimi i kullimit të ujerave, i cili është menduar të realizohet me ulluqe horizontale prej llamarine xingat të parapërgatitur sipas detajit të paraqitur në projekt, si dhe ulluqet vertikale të pozicionuara në pikat e shkarkimit nëpër kulme dhe zona të ndryshme të çatise sipas pjerresive që do të jepen gjatë zbatimit të projektit.

Lidhja e ulluqeve vertikale me ato horizontale do të realizohet nëpërmjet kasetave të shkarkimit, të cilat do të jenë të materialit llamarine xingat si vete ulluqet, pasi bashkimi i tyre realizohet me thjeshtë gjatë ndërtimeve me struktura metalike si objekti në fjalë.

6. Punime për Dyer dhe Dritare:

Dyert do të jenë tamburato në material druri dhe të pajisura me kase druri. Dyert e nyjeve hidrosanitareve do të jenë duralumin.

Persa i përket dritareve do të jenë duralumini ose duroplastike të cilësisë së parë me hapje me rrotullim dopio-xham. Gjithashtu për katet e para janë të parashikuara të gjitha normat e sigurisë, lartësia e dritareve nga toka si dhe pajisja e tyre me elementet metalike mbrojtës përkatës.

Të gjitha dritaret e ambienteve janë parashikuar me dopio xham për efekt termoizolimi.

Dritaret janë pjesë e rëndësishme arkitektonike dhe funksionale e ndërtesës.

Ato sigurojnë ndriçimin për pjesët e sipërfaqes së brendshme të tyre. Madhësia (dimensionet) e tyre variojnë, varet nga kompozimi arkitektonik, nga madhësia e sipërfaqes së brendshme dhe kërkesat e tjera të projektuesit. Dritaret duhet të jenë në kuotë 80-90 cm mbi nivelin e dyshemesë, kjo varet dhe nga kërkesat e projektuesit. Dritaret mund të jenë të prodhuara me dru, alumin ose PVC. Pjesët kryesore të dritareve janë: Kasa e dritares që fiksohet në mur me elemente prej hekuri përpara suvatimit. Korniza e dritares do të vidhohet me kasën e saj mbas suvatimit dhe bojatisjes. Në bazë të vizatimit të dritares së treguar në vizatimin teknik, korniza do të pajiset në kasë me mentesha dhe bllokues të tipeve të ndryshme të instaluar në te. Kanate me xham të hapshëm, të pajisur me mentesha, doreza të fiksuara dhe me ngjithës transparent silikoni, si dhe me kanata fikse.

Në dyert e brendshme prej druri tamburato, të trajtuara me mbulesë mbrojtëse të drunjte vendosen në kasa të bëra me dru pishe binarë 7 x 5 cm dhe dërrase të stazhionuar (me trashësi 4 cm), e dimensionuar sipas gjerësisë së murit, (duke marrë parasysh edhe rritjen prej mbulesës së murit). Kasa mbërthehet fuqishëm në mur me vida ose ganxha hekuri dhe mbulohen me llaç çimento.

Në dyert e brendshme prej alumini montohen në kasa fikse në formë profilesh tubolare prej duralumini me përmasa 61-90 mm, të cilat sigurohen me elemente të posaçëm për

OBJEKTI: “NDËRTIM I TREGUT BUJQËSOR NË LAGJEN MINATORI, BASHKIA BULQIZË”

fiksimit dhe mbërthimit në strukturat e mureve. Profilet fikse të kasës do të jenë me një mbulesë që është 25 mm brenda murit.

Në dyert e jashtme metalike do të montohen në një kasë metalike që fiksohet në mur me anë të ganxhave të çelikut të betonimit në mur përpara suvatimit. Kasa metalike duhet të jetë e lyer me bojë metalike kundra korrozionit para se të montohet në objekt. Madhësia e saj është në varësi të trashësisë së murit ku do të vendoset. Trashësia e fletëve të çelikut të kasës duhet të jetë minimalisht 1,5 mm. Gjerësia e pjesëve anësore të kasës duhet të jetë minimalisht 10 cm kurse gjerësia është në varësi të gjerësisë së murit dhe llojit të derës. Fletët e çelikut të kasës duhet të kthehen ose të saldohen sipas Kushteve Teknike të Zbatimit. Kasa duhet të lyhet me bojë të emaluara transparente përpara fiksimit të derës. Të gjitha punët e lidhura me instalimin dhe vendosjen e kasave të dyervë në objekt duhet të bëhen sipas kërkesave teknike të të projektit.

7. Rifiniturat e dyshemeve dhe shkallet:

Shtrimi i dyshemeve do të bëhet me pllaka grez ose porcelanat importi. Fugat e pllakave duhet të jenë paralele me muret e ndërtesës. Prerja e pllakave duhet të bëhet sa më afër murit, po ashtu duhet që pllakat e prera të jenë sa më të mëdha. Do të vendosen gjithashtu plintuset në gjithë perimetrin e brendshëm të ambjenteve me $H = 10$ cm.

Shkallë betoni veshur me mermer.

Për veshjen e shkallëve të betonit me mermer duhet të parashikohen këto punë:

Në fillim duhet që shkallët e betonit të pastrohen mirë si dhe të rrafshohet vendi. Pastaj duhet që shkalla prej betoni të lyhet me qumësht çimentoje, i cili e lehtëson ngjitjen e pllakave të mermerit. Ngjitja e pllakave të mermerit bëhet ose duke përdorur llaç ose në rast se shkallët e betonit janë të rrafshta, atëherë mundet që këto të ngjiten edhe me kollë. Ngjitja e pllakave të mermerit nuk ndryshon nga ngjitja e pllakave në mur, pikë e cila është përshkruar gjerësisht.

8. Punime Elektrike dhe Hidraulike brenda godines:

Keto punime janë trajtuar gjerësisht në Specifikimet Teknike të Projektit.

9. Punime për Mobilimin e Tregut:

Persa i takon anes teknike është menduar të realizohet mobilimi me tavolina të permasave kryesisht 120 x 150 cm, të cilat do të realizohen me profile metalike të permasave 40 x 40 mm me saldim, si dhe do të mbulohen me derrasa pishe me trashësi $t = 5$ cm, qofte nga

OBJEKTI: “NDËRTIM I TREGUT BUJQËSOR NË LAGJEN MINATORI, BASHKIA BULQIZË”

lart ashtu edhe ne anesore derisa te marre formen e saj per perdorim si tavoline mbeshtetese te mallrave te ndryshme qe do te tregtohen ne keto ambiente.

Pozicionimi dhe numri i vendshetjeve mund te pershtatet edhe nga Investitori ose Mbikqyresi gjate zbatimit te punimeve, ne te kundert do ti referohemi Projektit.

10. Punime per Sistemimin e Jashtem:

Pas ndertimit dhe kompletimit te godines se Tregut Bujqesor sipas punimeve te zerave te preventivit dhe vizatimeve (detajeve perkatese) lind nevoja edhe per sisteme te jashtme te sheshit ku do te pozicionohet kjo godine.

- a. Fillimisht do te behet rrethimi i te gjithë sheshit qe do te shfrytezohet per kete Investim, rrethim i cili do te realizohet me rrjete teli ne lartesi rreth 2m nga kuota e themelit perimetral te rrethimit, e cila do te fiksohet me nje brez betoni mbi te, si dhe ne cdo 2m gjeresi me profile metalike tubolare.
Ne zonen veriore te sheshit do te ndertohet mur betoni mbajtes pasi terreni eshte i thyer, mbi te cilin do te vijohet me rrethimin.
- b. Sheshi brenda ketij rrethimi do te kete funksionin e parkimit dhe qarkullimit te mjeteve qe do te perdoren per furnizimin e tregut me mallra te ndryshem, si dhe qarkullimin e banoreve e tregtareve per shit-blerjen e produkteve te ndryshme. Prandaj zona do te sistemohet ne shumicen e siperfaqes se saj me paketen e plote te shtresave rrugore (çakell + stabilizant + binder + asfaltobeton), dhe ne zona te ndryshme do te sistemohet me pllaka trotuari per kembesoret.
- c. E nevojshme eshte edhe sistemimi i ujerave siperfaqesore te sheshit, te cilat do te trajtohen nepermjet kanaleve nentokesore me kalime me tub HDPE te d=250mm, te mbuluara me rere e zhavorr, si dhe pusetat siperfaqesore me kapak gize nepermjet te cilave do te behet trajtimi dhe orientimi i ujerave ne pikat e posaçme.
- d. Ne sistemimin e sheshit vlen te permendim edhe ndriçimin e tij, nepermjet shtyllave te larta 7m metalike, te pozicionuara ne kater qoshet e sheshit ne menyre qe te ndriçohet e gjithë siperfaqja e tij pasi do te perdoren ndriçues LED 250W. Do te realizohen te gjitha punimet e nevojshme per sistemin e ndriçimit te jashtem sipas zerave te preventivit dhe detajeve te Projektit te Zbatimit.

PËRGATITI:

“ALBGOLDING 2E” sh.p.k

Drejtues Teknik:

Ing. HAJREDIN MURGU

